



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

**Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief
State Prosecutor**

A.nr.112/2024

Datë: 03.03.2025

Prishtinë

Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit i Shtetit, pas takimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës të mbajtur më datë 05.02.2025, dhe në pajtim me nenin 20 paragrafi 1 nënparagrafi 1.9 të Ligjit nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës, shmangies së neglizhencës dhe mos zbatimit të ligjshmërisë, nxjerr këtë:

UDHËZIM

Për zbatimin e detyrueshëm të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK.nr.85/2025 të datës 05.02.2025, lidhur më kallëzimet penale më kryes të pa njohur të veprave penale

1. Detyrohen të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët që Vendimin e sipërcekur ta zbatojnë në përputhje më dispozitën e nenit 154 të Kodit të Procedurës Penale, ashtu që për secilën lëndë nga regjistri PPP, prokurorët e rastit së bashku më kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse, çdo tre (3) muaj, duhet të shqyrtojnë dhe pas shqyrtimit, më shënim zyrtar, në formë të shkruar, të konstatojnë gjendjen aktuale në rastin konkret dhe nëse ka nevojë për ndonjë veprim ligjor në drejtim të ndjekjes penale.
2. Shqyrtimi i këtyre rasteve, sipas paragrafit një të këtij udhëzimi, duhet të vazhdoj deri në zbulimin e kryerësit të veprës penale, ose deri në parashkrimin e ndjekjes penale apo deri në zgjidhjen përfundimtare të ndjekjes penale
3. Lidhur më rastet e sipërcekura duhet të raportohen në mënyrë të veçantë apo të mos përfshihen në raportet vjetore të sistemit prokurorial dhe në analizat statistikore së bashku më kallëzimet penale më kryes të njohur.
4. Mos respektimi i këtij udhëzimi konsiderohet si shkelje disiplinore e prokurorëve, sipas dispozitës së nenit 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 të Ligjit Nr. 06/l - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

5. Pjesë e këtij Udhëzimi është edhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK.nr.85/2025 të datës 05.02.2025
4. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.



- Udhëzimi i dërgohet:
- KPK
- Kryeprokurorëve.
- Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.